



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.539/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Nenad Laziq dhe Franciska Ymeri – Zhitija, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit E. S. nga V., të cilin e përfaqëson Avokati Veli Hoti nga P., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Sh.A. në P., të cilën e përfaqëson G. H., për shkak të anulimit të vendimit dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.727/2022 datë 04.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.12. 2024, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit E. S. nga V., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.727/2022 datë 04.09.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.727/2022 të dt.04.09.2024 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri C.nr.948/21 i datës 16.12.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet padia dhe kërkesëpafia e paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e

vendimeve të paditurës nr..., dt.4.05.2018 dhe vendimit nr..., dt.22.05.2018, me të cilat i është ndërprerë kontrata e punës nr..., e cila ka qenë në fuqi nga data 1.01.2016 dhe kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kohore prej 29.03.2018 e deri më dt.15.11.2021, në shumën neto prej 20.546,12 euro, si dhe kamatën për periudhën prej 11.06.2018 deri 15.11.2021, në shumën prej 2.984,89 euro, në shumën e përgjithshme prej 23,531.01 euro, për Trustin Pensional shumën prej 1027,30 euro, për kontributin në paga që duhet të paguajë në ATK- punëdhënësi në shumën prej 1506,86 euro, ndërsa, prej dt.15.11.2021 e tutje pagën bruto prej 530 euro e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, me kamatë prej 8% në kuptim të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1104 euro, si e pa bazuar. Me pjesën e II të dispozitivit secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve qenësore të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, të ndryshohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë, ose të pranohet revizioni, të prishen aktgjykimet e instancave më të ulëta, duke ia kthyer lëndën gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi më dt.11.06.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimeve të lartë përmendura të së paditurës mbi shkëputjen e kontratës së punës, kompensimin e të ardhurave personale, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë dhe precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se sipas kontratës së punës dt.1.01.2016, paditësi ishte në marrëdhënie të punës tek e paditura në pozitën Koordinator për transport dhe mirëmbajtje të ndërtesës. I padituri më datën 13.10.2014, me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga neni 7.1 nënp. (h),(I) të Kodit Disiplinor të KEDS-it dhe për këtë me vendimin e të paditurës nr..., dt.4.05.2018, i shqiptohet masa disiplinore, ndërprerja e kontratës së punës nr..., pa periudhë paralajmërimi – njoftimi, (

pjesa I dhe II e dispozitivit të vendimit) dhe punëmarrësit E. S., këtu paditësit, i ndërpritet vendimi me nr...., i dt.29.03.2018 mbi suspendimin- largimin e përkohshëm nga puna (pjesa e III e dispozitivit të vendimit të paditurës). Kështu, nga se në bazë të njoftimit të Auditorit të Brendshëm të dt.29.03.2018, është filluar procedura disiplinore për shkelje të rënd të detyrave të punës nga neni 7, par.7.1, nënpar. (I) (h) të Kodit Disiplinor të KEDS-it, në atë mënyrë që, më dt.28.03.2018, në Zyrën e Auditorit të Brendshëm në KEDS, ishte paraqitur një qytetar me emrin E. L. nga rajoni i M. i cili e kishte denoncuar me shkrim punëmarrësin e KEDS-it, këtu paditësin, E. S., se punëmarrësi E. S. kishte qenë ndërmjetës mes prindit të qytetarit në fjalë dhe pronarit të Kompanisë “T. M. D.” (lidhur me ndërtimin e bazamentit dhe vendosjen e transformatorit – TS.SH.M. 100 KVA në objektin e E. L., në vlerë prej 7,350.00-euro, më hollësisht, si në administrimin e provave që gjenden në shkresat e lëndës), për të realizuar punimet E. – E. të P. PEE, për këtë ndërmjetësim, sipas konsumatorit E. L., (i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit) punëmarrësi E. S. (paditësi) kishte pranuar shumë e parave prej 1000-euro, që ia kishte dhënë babai i tij, i ndjeri A. L., e që punimet nuk ishin realizuar në këtë objekt të biznesit sipas zgjidhjes teknike të propozuar nga KEDS-i.

Konsumatori në Zyrën e Auditorit të Brendshëm kishte prezantuar një letër (provë-dokument) në të cilën është paraqitur një ofertë për realizimin e punëve të instalimit e cila përmban faksimilin me emrin E. S., dhe nënshkrimin e tij. Paditësit, nga Arbitri- Drejtori i Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta të KEDS, i është shqiptuar edhe një vërejtje me shkrim në një rast tjetër disiplinor, të cilën shkelje disiplinore e ka kryer më dt. 10.10.2017. Pra, lidhur me këtë, del se, paditësi kishte shkruar shkresën e emërtuar OFERT dhe se ka pranuar të holla nga porositësi i punimeve E. L., për të ia dorëzuar Kompanisë T. M. D., gjë që, e ka pranuar edhe vet gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje, mirëpo, me pretendimin se e ka bërë në mënyrë shoqërore, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm mbi ndalesat e tij sipas Kodit Disiplinor dhe të Punës të paditurës. Ai edhe më parë ka bërë shkelje disiplinore pranë të paditurës dhe i është shqiptuar vërejtje me shkrim dhe atë me vendimin nr..., dt.4.05.2018, ndaj, për shkak të shkeljes së rënd të sipër përmendur të detyrave të punës, të njëjtit, edhe i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e kontratës së punës.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës në pajtim me dispozitën e nenit 7, par.7.1(h), (I), të Kodit Disiplinor, nenit 50.1 pika c) të Kodit të Punës, si dhe nenit 70.4 të Ligjit të Punës, ndaj, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka konstatuar se e njëjta, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pathemeltë dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Në këtë gjendje të kësaj çështje civile – juridike, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët, kur kanë vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht refuzimin e ankesës së paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Aktgjykimi përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Ndaj, pretendimet e revizionit të palës paditëse, për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, nuk mund t'a vënë në dyshim aktgjykimin e goditur. Po ashtu aktgjykimet e lartë cekura, nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet nga revizioni. Kjo për arsye se, sikundër kanë gjetur edhe gjykatat e instancës më të ulët, vendimi i të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës është marrë në përputhje, veç tjerash, me dispozitat e nenit 7, par. 7.1, nënp. (h), (I) të Kodit Disiplinor të së paditurës, nenit 50.1, pika c) të Kodit të Punës, respektivisht, nenit 70.4, nenit 85, nenit 86 të Ligjit të Punës, të cilat dispozita parashohin, përkatësisht, rregullojnë rastet dhe konditat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të cilat, në rastin konkret, ishin përmbushur. Në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar edhe faktin se në shkresat e lëndës ka prova se vendimit të lartë cekur të së paditurës i ka paraprirë zhvillimi i procedurës disiplinore nga organi kompetent i saj, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe aktit të brendshëm të saj, ka vërtetuar shkeljen e rënde të detyrave të punës, në kohën dhe mënyrën e sipër përshkruar si dhe ekzistimin e përgjegjësisë disiplinore të paditësit, prandaj, ka vërtetuar në mënyrë ligjore se paditësi ka bërë shkelje të rënde të detyrave të punës, për çfarë i ka shqiptuar masën përkatëse disiplinore të paraparë me dispozitat e sipër

përmendura ligjore. Kështu, në kontekstin e këtij rasti konkret civil, duhet vënë re, se me dispozitën e nenit 70.4 të Ligjit të Punës, përcaktohet që “Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t’i specifikojnë llojet e keq sjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuar t’i nënshtrohet ndërprerjes së kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura”. Me nenin 7 (titulluar Shkeljet e Rënda nga një Punëmarrës), nënp.7.1, pika h) të Kodit Disiplinor të paditurës, përcaktohet që “ Keqpërdorimi nga Punëmarrësi i pozitës së tij apo tejkalimi i kufizimeve të tij, me qëllim të sigurimit të përfitimit joligjor material për vete apo ndonjë person tjetër apo ndonjë organizatë biznesore apo për të shkaktuar ndonjë dëm te personat tjerë apo organizatat biznesore” dhe pika D) “ Veprimet e pakujdesshme në kryerjen e detyrave që i shkaktojnë dëm pronës apo financave të KEDS-it, apo pronës së palës së tretë, apo lëndime personale. Kjo duhet të përfshijë të qenit i pamatur apo shumë i shkujdesur në dorëzimin në KEDS apo palëve tjera dokumentacion, të dhëna apo shënime false, të pa sakta apo mashtruese. Në këtë kontekst, shmangja me vetëdije , injorimi i ligjit apo injorimi i vetëdijshëm nuk është arsyetim ”. Në përputhje dhe në kuptim edhe të dispozitave të sipër përmendura, është vërtetuar se paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, dhe pas vërtetimit të ekzistimit të përgjegjesisë disiplinore, paditësit, i ka shqiptuar masën përkatëse disiplinore.

Prandaj, nga këtu, nuk qëndrojnë as thëniet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.539/2024 datë 11.12. 2024

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha